



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 24.02.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **22.02.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik Techbase SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RITENDER "Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS"** me Nr. të Prok: 206-23-571-2-1-1 nxjerr:

V E N D I M

1. **Pranohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik Techbase SH.P.K. të dt.22.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit RITENDER "Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS", me Nr. të Prok: 206-23-571-2-1-1, kundër *Njoftimit për Kontrate*, të datës 03.02.2023 të publikuar në platformën elektronike.
2. **Korrigjohet Dosja e tenderit në gjuhën angleze dhe serbe, e publikuar me datë: 03.02.2023;**
3. Autoriteti Kontraktues, pas njoftimit për korrigjim do të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik Techbase SH.P.K. me datë 22.02.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: RITENDER "Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS", me Nr. të prokurimit: 206-23-571-2-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 24.02.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE Techbase SH.P.K.: Neni 1, 7 dhe 13 i LPP-se.

Pretendimi ankimor

Bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 neni 13 Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik, pika 1 dhe pika 2 citojmë:

1. Autoriteti kontraktues do ti përgatisë të gjitha dosjet e tenderëve, njoftimet, ftesat dhe dokumentet e tjera që janë publikuar ose u janë dhënë operatorëve ekonomik gjatë ushtrimit të një aktiviteti të prokurimit që shpjen drejt dhënies së një kontrate ose konkursi të projektimit me vlerë minimale, të vogël dhe të mesme në gjuhën Shqipe dhe Serbe. **Autoriteti kontraktues mundet që gjithashtu t'i përgatisë dokumentet në fjalë edhe në gjuhën Angleze.**

2. Autoriteti kontraktues do ti përgatisë të gjitha dosjet e tenderëve, njoftimet, ftesat dhe dokumentet e tjera që janë publikuar ose u janë dhënë operatorëve ekonomik gjatë ushtrimit të një aktiviteti të prokurimit që shpjen drejt dhënies së një kontrate ose konkursi të projektimit me vlerë të madhe në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze."

Ne kundërshtim te plote me LPP nr. 04/L-042 , AK-Ministria e Shëndetësisë, ne te tri gjuhet e dosjes se tenderit, ANEKSI 1-Specifikimet Teknike te Detyrueshme, i ka ngarkuar vetëm ne gjuhen shqipe, dhe jo ne dy gjuhet tjera zyrtare (Serbe dhe Angleze), ne te cilat duhet te jete e përgatitur dosja e tenderit.

Andaj bazuar ne nenin 1 dhe 7 te LPP nr.04/L-042, kerkojme qe Dosja e tenderit, gjegjesit Aneks 1-Specifikimet Teknike te Detyrueshme, te perditesohen dhe te jete e gjitha dojsa ne tri gjuhet zyrtare, dhe e njejta te ngarkohet dhe ne platformen e-Prokurimi.

Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

Ne platformën e-prokurimi ekziston Dosja e tenderit ne tri gjuhet: Shqip, serbisht, anglisht.

Specifikimi teknik ne Aneks 1 është përshkruar ne gjuhen shqipe ne formën si është përgatitur nga komisioni profesional i Njësisë se Kërkesës dhe ASHI-se, me qellim qe mos te këtë defekte gjate përkthimit apo dykuptimësi, duke marre parasysh rëndësinë e projektit dhe nevojën për realizim sa me shpejte qe është e mundur me afat te shkurtuar. Sidoqoftë ne do ta plotësojmë DT siç keni kërkuar.


Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Vendimi i dorëzohet:

1. TECHBASE SHPK
2. Operatoreve ekonomik te interesuar


Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

